



KONTROLLI I LARTË I SHETIT K R Y E T A R I

Nr. 573/7 Prot.

Tiranë, më 23/09/2016

V E N D I M

Nr. 111, Datë 23/09/2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT DURRËS “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimin financiar dhe menaxhimin e administrimin e aseteve të qëndrueshme”, të ushtruar në Këshillin e Qarkut Durrës, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 30.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës nuk ka zbatuar rekomandimet e KLSH, konkretisht:

a. Nuk ka zbatuar 2 masa organizative, përkatësisht:

-vlera debitore 64 mijë lekë për vitin 2012, për të cilën nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për arkëtimet e debitorëve të krijuara ndër vite, duke sjellë për pasojë edhe rritjen e debitorëve në vlerën 247 mijë lekë.

-vlera 6,550 mijë lekë për vitin 2011 dhe vlera 17,440 mijë lekë për vitin 2012, nga mos pagesa e kuotës të anëtarësimit të Bashkive dhe Komunave në Këshillin e Qarkut.

b. Nuk ka kontabilizuar dhe arkëtuar rekomandimet e lëna për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,871,911 lekë**, përkatësisht:

-vlera 432,446 lekë, nga subjekti “XXXXXXXXXX”, përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt: “Konferenca e AER viti 2009”.

-vlera 407,000 lekë, nga shoqëria “XXXXXXXXXX”, përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt: “Projekti për urën e Hardhishtës viti 2009”.

-vlera 360,821 lekë, ndaj M.K. në cilësinë e anëtarit të KVO.

-vlera 134,886 lekë ndaj B.S. në cilësinë e anëtarit të KVO.

-vlera 335,821 lekë, ndaj A.P. në cilësinë e anëtarit të KVO.

-vlera 127,935 lekë, ndaj E.S. në cilësinë e anëtarit të KVO.

-vlera 73,000 lekë, ndaj L.L. në cilësinë e anëtarit të KVO.

1.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara nga auditimet e mëparshme të KLSH dërguar respektivisht me shkresat nr. 574/6, datë 17.10.2013 dhe nr.117/10, datë 17.11.2010.

Brenda vitit 2016

2. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës ka kryer largime të padrejta nga puna, procedura për të cilat punonjësit e larguar pas ankimimit në gjykatë kanë fituar të drejtën e pagesës për vlerën totale 15,893,043 lekë, vendimmarrje e cila ka ndikuar negativisht në buxhet, pasi për të njëjtin vend pune janë kryer pagesa të dubluara. Këshilli i Qarkut Durrës nuk ka animuar në të gjitha shkallët e gjyqësorit vendimet respektive për ish-punonjësit S.S. dhe M.K., si dhe nuk ka nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, në kundërshtim me UMF nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 62 dhe 102.

Nuk janë planifikuar fonde për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në shumën 15,893,043 lekë, për 20 punonjës të larguar nga puna dhe nga ristrukturimi i administratës, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr.178/2014, neni 66/1 dhe në UMF nr.2, datë 09.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, pika 46.

2.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktar të krijimit të detyrimit në vlerën 15,893,043 lekë, për largime të padrejta nga puna, shumë e cila ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit, si dhe të marrë masa për likuidimin e vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara në shumën 15, 893, 043 lekë.

Në Vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, sipas nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk ka strategji të riskut apo identifikim të tij; Nuk ka dokumente që pasqyrojnë bashkëpunimin me menaxherët e tjerë të institucionit për krijimin e regjistrit të riskut; Nuk ka rivlerësim dhe matja vjetore të riskut të veprimtarisë së njësive dhe si pasojë as identifikimi i përgjigjeve ndaj çdo risku; Nuk është formuluar deklarata e vizionit dhe misionit të njësive në të cilën përcaktohen objektivat strategjike afatgjatë, sipas VKM nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020”; Nuk është hartuar “Raporti përmbledhës mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

3.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës, të marrë masa për caktimin e koordinatorit të riskut të njësive, ngritjen e regjistrit të riskut, hartimin e strategjisë së tij, deklaratën e vizionit, hartimin e raportit përmbledhës mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe trajnimin e personelit, me qëllimi implementimin dhe zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” .

Në Vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës ka përdorur padrejtësisht fondet e projekteve të huaja për pagat e punonjësve në shumën **15,404,854 lekë** në shkelje të disiplinës financiare, pasi kanë ndryshuar destinacionin e fondeve të projekteve të huaja të akorduara, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe pikat 46 dhe 47 të UMF nr.2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”.

4.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të marrë masa për respektimin e marrëveshjeve me donatorët e huaj, për përdorimin e fondeve të huaja në destinacionin përkatës.

Në Vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës ka mungesë të inventarizimit të aseteve në administrim apo përdorim, në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 11.12.2000 “Për kalimin e këshillave të qarqeve të ambienteve të punës, pajisjeve dhe numrit të ish këshillave të rretheve”.

5.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të finalizojë procesin e inventarizimit të pronave në administrim apo në përdorim, të kryejë kontabilizimin dhe më pas edhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Durrës, procedura sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Brenda vitit 2016

6. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës, lidhur me procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10346, datë 04.11.2010 “Për ankandet”, i ndryshuar nenet 1, 3, 4 dhe 6, me ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor” i ndryshuar neni 99 dhe 102 dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 2, pasi:

a. automjeti me targë DR 6444C, blerë në vitin 2002 me vlerë 1,775,000 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit pa përfunduar procesi i asgjësimit dhe pa u bërë hyrje pjesët e këmbimit dhe skrapit.

b. automjeti me targë DR 9073D në vlerë 990,000 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit pa kryer më parë pagesën e detyrimeve vjetore (taksave), kusht për çregjistrimin e automjetit.

6.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të marrë masa për çregjistrimin e targave dhe administrimin e pjesëve të këmbimit dhe skrapin e automjeteve të nxjerra jashtë përdorimit, duke vijuar më tej me procedurat e shitjes të skrapit në ankand.

Brenda vitit 2016

7. Gjetje nga auditimi: Këshilli Qarkut Durrës nuk ka zbatuar procedurat e kalimit në pronësi të ambienteve të ish-ORMM (Oficina e remontit të makinave metalprerëse), në kundërshtim me pikën 14 të VKM nr.500 datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; ka lidhur kontratë me afat 20 vjeçar, për dhënien me qira shoqërisë “[REDACTED]” shpk, të ish-ORMM në sipërfaqen 1405 m², procedura të kryera pa regjistruar më parë pronën në ZVRPP Durrës, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

7.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës, të marrë masa për regjistrimin në pronësi pranë ZVRPP Durrës të ish-ORMM, sipas kërkesave të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe regjistrimin e kontratës së lidhur me shoqërinë “[REDACTED]” sh.p.k, për dhënien me qira ambienteve në sipërfaqen 1405 m².

Brenda vitit 2016

8. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Durrës, lidhur me administrimin e aseteve në pronësi apo përdorim nuk ka mbajtur procesverbale për dorëzimin e dosjeve me inventarin përkatës, po ashtu dhe kalimi i praktikave nga struktura e mëparshme në atë aktuale të krijuar me VKQ Durrës nr.2, datë 30.01.2015, është bërë pa mbajtur akte inventarizimi e dorëzimi, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik, Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, regjistri i aktiveve të njësitë të sektorit publik, pika 26.

8.1 Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të aseteve dhe mbajtjen e proces verbaleve të marrjes në dorëzim, procedurë të cilën duhet ta realizojnë specialistët e ngarkuar me ndjekjen dhe administrimin e aseteve.

Brenda vitit 2016

9. Gjetje nga auditimi: Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, është shkruar me VKQ Durrës nr. 2, datë 30.01.2015, pa marrë miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 9244, date 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

9.1 Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës, të marrë masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës me qëllim ringritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës së Qarkut Durrës, duke marrë në konsideratë disponibilitetin prej tij të sipërfaqes së tokës prej 76 mijë hektarë.

Brenda vitit 2016

10. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në bashkëpunim me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit (TI) ka kryer procesin e dixhitalizimit të dokumentacionit, përshkrimin dhe skanimin e 60% të arkivit të Kadastrës, nga librat e pronësive të regjistruara para hyrjes në fuqi të ligjit 108/1945 “Për reformën agrare”, proces i ndërprerë në vitin 2014, me shkurtrimin e sektorit të TI.

10.1 Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës, të marrë masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës me qëllim ringritjen e përkohshme të sektorit të TI, për përfundimin e procesit të dixhitalizimit të dokumentacionit të arkivës (regjistrave të tokës) me qëllim krijimin e Sistemit të

Informacionit për tokën bujqësore (LIS), kjo bazuar në VKM nr. 683, datë 13.12.2001 “Për riorganizimin e rrjetit arkivor vendor”.

Brenda vitit 2016

11. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

11.1. Rekomandim: Këshilli Qarkut Durrës, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Brenda vitit 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi procedurave administrative”, pjesa V, kreu I “Akti administrativ”, nenet 98-102, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 21-33 “Funksionimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil”, nenet 608-628 në vijim, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e Kryetarit të Këshillit Qarkut Durrës, të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 7,246,842 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni Rrugët e Kënetës (Bisht Kamza)”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **3,890,732 lekë**, pa tvsh, në kundërshtim me kontratën nr. 909/1, datë 25.01.2013.

1.1.Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **3,890,732 lekë**, pa tvsh, nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës nr. 909/1, datë 25.01.2013, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit Nëntor 2016

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i Rrugës Nacionale Qendër-Manskuri”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **3,159,910 lekë**, pa tvsh, në kundërshtim me kontratën nr. 850/1, datë 04.01.2013.

2.1.Rekomandim: Këshilli i Qarkut Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **3,159,910 lekë**, pa tvsh, nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas kontratës nr. 850/1, datë 04.01.2013, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit Nëntor 2016

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua vlera **196,200 lekë** dëm ekonomik, për një drekë me rastin e festave të 28-29 nëntorit (për 100 veta), sipas urdhër shpenzimit nr. 287, datë 16.12.2014, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar dhe me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

3.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të arkëtojë vlerën prej **196,200 lekë**, për organizimin e një drekë me rastin e festave të 28-29 nëntorit për 100 veta me nga 1,962 lekë/secili, shpenzim të kryera pa një mbështetje ligjore.

Brenda muajit tetor 2016

C. MASA ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, Këshilli i Qarkut Durrës, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Durrës, **të vendosë masë administrative me gjobë, për 2 mbikëqyrësit dhe 2 kolaudatorët**, sa vijon:

1. ing. P.D. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës “*Rikonstruksioni Rrugët e Kënetës (Bisht Kamza)*”, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë në vlerën **3,890,732 lekë**, pa tvsh, për punime të pakryera. Veprime në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 3.

2. ing. M.K. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës “*Rikonstruksioni Rrugët e Kënetës (Bisht Kamza)*”, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë në vlerën **3,890,732 lekë**, pa tvsh, për punime të pakryera. Veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 3.

3. ing. D.O. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me “*Rikonstruksion i Rrugës Nacionale Qendër-Manskuri*”, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë në vlerën **3,159,910 lekë**, pa tvsh, për punime të pakryera. Veprime në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 3.

4. ing. Sh.R. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me “*Rikonstruksion i Rrugës Nacionale Qendër-Manskuri*”, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë në vlerën **3,159,910 lekë**, pa tvsh, për punime të pakryera. Veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 3.

D. MASA DISIPLINORE

VO: Punonjësit kryesor që atakohen me problemet e ngritura në raportin e auditimit nuk janë në marrëdhënie pune me Këshillin e Qarkut Durrës, nisur nga shkeljet e konstatuara do të kërkonim masë disiplinore, por meqenëse janë larguar nga institucioni, këto masa quhen të ezauruara, për:

1. Th.L. Drejtor Ekonomik, larguar më 18.02.2015,
2. L.M. Përgjegjëse e Financës, larguar më 12.02.2015,
- 3 M.K. Përgjegjësen e Sektorit Juridik, larguar më 01.06.2015,
- 4.A.I. larguar,
- 5.E.S. larguar,
- 6.M.C. larguar,
7. D.L. larguar,
8. A.R. larguar.

E. TË TJERA

Auditimi i kryer në Këshillin e Qarkut Durrës, vlerësohet shumë dobët nga Kryetari i KLSH-së dhe do të riauditohet në një kohë të dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R